



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE**  
**Up1 Nr.08-425**  
**26.11.2021**  
**Shkup**

Në pajtim me nenin 18, paragrafi 1, nëparagrafi 2, nenin 82, paragrafi 1, nëparagrafi 5 dhe nenin 83 të Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare Maqedonisë “, бр.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 и 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20 dhe 77/21), e në lidhje me nenin 62, paragrafi 6, të këtij ligji, nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapsinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.172/14 dhe 76/15), nenin 51, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenin 52, paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.124/15), nenin 28 të Ligjit të Kontesteve Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.96/19), duke vepruar sipas propozimit Up1 nr.08-425 datë 12.11.2021, për ngritjen e procedurës për marrjen e lejes së emetimit të radios të Shoqërisë tregtare radiodifuzive RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP dhe propozimin Up1 nr.08-425 datë 24.11.2021 për miratimin e vendimit për marrjen e lejes për emetim të radios të Shoqërisë tregtare radiodifuzive RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP, dhe në përputhje me konkluzionin nr.02-4259/3 datë 26.11.2021, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 34 -të e mbajtur më datë 26.11.2021 ka miratuar:

**VENDIM**  
**për marrjen e lejes së emetimit të radios të Shoqërisë tregtare radiodifuzive**  
**RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP**

1. I MERRET leja e radioemetimit, nr.08-86 datë 05.1.2015 të Shoqërisë tregtare radiodifuzive RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP, për shkak se pas marrjes së lejes janë krijuar rethana të cilat krijojnë pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për ta kryer këtë veprimtari, respektivisht për shkak se radiodifuzori nuk i ka plotësuar kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapsinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes së emetimit të radios ose të televizionit.

2. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e komunitetit joshumicë, por që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim është përfundimtar.

**A r s y e t i m**

Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP, është zotërues i lejes për radioemetim, nr.08-86 datë 05.01.2015, për emetimin nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal (komuna e Manastirit), radioservisi programor, radioprogram muzikor me format të përgjithshëm , në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 62, paragrafi 6 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për sigurimin e emetimit televiziv ose të radios, krahas kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, radiodifuzori duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit, varësisht nga formati programor, të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga ana e Agjencisë.

Në nenin 9, paragrafi 4 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes së emetimit të radios dhe të televizionit, është përshkruar se numri dhe struktura të punësuarve për radio në nivel lokal duhet të jetë 3 (tre) persona, nga të cilët 2 (dy) prej tyre me përgaditje të lartë arsimore (PLA), të punësuar si gazetarë.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 i këtij ligji, Agjencia do t'ia marrë lejen e emetimit të radios ose të televizionit para kalimit të afatit për të cilin është lëshuar dhe do ta fshijë radiodifuzorin nga regjistri i radiodifuzorëve, pas njoftimit të bërë me shkrim, nëse pas dhënies së lejes, krijohen rrethana që paraqesin pengesë ligjore që pronari ta realizojë këtë veprimtari.

Në pajtim me nenin 27, paragrafi 1 të LSHMAV-së, Agjencia realizon mbikëqyrje administrative, i cili kryhet për punën e publikuesit të medieve nga aspekti i pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara me Ligjin e Medieve, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij. (neni 29, paragrafi 1 të LSHMAV).

Në pajtim me nenin 27, paragrafi 4 të LSHMAV, Agjencia realizon mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative, në bazë të nismës së paraqitur nga organet shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Më datë 14.9.2021, tek Agjencia SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP dorëzoi njoftim me shkresë (nr.03-3387/1), me çka ka kërkuar nga radiodifuzori që brenda shtatë ditëve nga pranimi i letrës të dorëzojë dokumente, nga të cilat mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes së emetimit të radios dhe të televizionit, respektivisht se ka punësuar si gazetarë tre persona, dy prej të cilëve me arsim të lartë (PLA). Më 21 shtator 2021, radiodifuzori ka dorëzuar kontrata për punë në Agjenci vetëm me dy persona. Marrëveshjet janë dorëzuar me e-mail, në përputhje me Rregulloren për mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit shoqërues në korrespondencë dhe raporte në arkivin e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale. nr.01-4993/1 datë 14.10.2014, duhet të dorëzohet në arkivin e Agjencisë në origjinal ose kopje të noterizuar. Po ashtu, edhe për këta dy persona radiodifuzori nuk ka dëshmi se ata kanë arsim të lartë. Për këtë, Agjencia edhe një herë i është drejtuar me shkrim radiodifuzorit (Njoftin nr. 03-3387/2 nga data 25.10.2021) me çka i është treguar se duhet të dorëzojë në mënyrë të rregullt gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Afati për dorëzimin e dokumenteve ka kaluar më 2.11.2021, dhe më datë 9.11.2021. (kur është kryer një mbikëqyrje e jashtëzakonshme, sipas detyrës zyrtare nga Agjencia), radiodifuzori nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion.

Rrjedhimisht, ashtu sikurse më sipër, Agjencia, nëpërmjet Sektorit të planifikimit strategjik dhe të të drejtave të autorit, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative me urdhër zyrtar për punën e SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP, me çka në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, nr.03-4128/1 datë 9.11.2021., kostatoi se SHTR RADIO AKTUEL Manastir, nuk i plotëson kushtet minimale të kuadrit, të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes së emetimit të radios ose të televizionit.

Duke marrë parasysh konstatimin e shkëlqes së nenit 62, paragrafi 6 të LSHMAV dhe nenit 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes së emetimit të radios ose të televizionit, e në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të ligjit të cituar paraprakisht në raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative nr.03/4128 datë 9.11.2021, u dha propozimmasë që

drejtori i Agjencisë të dorëzoje propozim të këshilli për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes së radioemetimit të SHTR RADIO AKTUEL Manstir SHPKNJP, nr.08-86 datë 05.01.2021.

Në nenin 23, paragrafi 1, nëparagrafi 3 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, është përcaktuar se nëse konstatohet mosrespektim i dispozitave të ligjit të cituar dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe të kushteve dhe obligimeve të përcaktuara sipas lejes dhe akteve të tjera të Agjencisë, kundër publikuesit të medias, drejtori i Agjencisë mund të marrë masa, respektivisht të dorëzojë të këshilli një propozim për marrjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia do ta heqë lejen për emetim të radios ose të televizionit para kalimit të afatit për të cilin është lëshuar dhe do ta fshijë radiodifuzorin nga regjistri i radiodifuzorëve, pas njoftimit të bërë me shkrim, nëse pas dhënies së lejes, krijohen rrethana që paraqesin pengesë ligjore që pronari ta realizojë këtë veprimtari.

Procedura e marrjes së lejes për emetim të radios ose të televizionit, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e inicon këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke marrë parasysh shkeljen e konstatuar të nenit 62, paragrafi 6 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e në lidhje me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të ligjit të cituar, drejtori i Agjencisë dorëzoi propozim Up1 nr.08-425 datë 12.11.2021. për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për radioemetim të SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 33-të të mbajtur më datë 17.11.2021, me konkluzionin nr.02-4171/9 datë 17.11.2021, e miratoi propozimin Up1 nr.08-425 datë 12.11.2021, për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për radioemetim të SHTR RADIO AKTUEL Manstir SHPKNJP, të dorëzuar nga propozuesi, drejtori i Agjencisë, dr Zoran Trajčevski.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes për radioemetim të SHTR RADIO AKTUEL Manstir SHPKNJP, nr.08-86 datë 5.1.2015, e në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të LSHMAV, Agjencia tek radiodifuzori i përmendur dorëzoi njoftim (Up1 nr.08-425 datë 19.11.2021.), në të cilin i është potencuar se nëse nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm nga i cili mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit, këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pranimi i propozimit të drejtorit të Agjencisë, nr.Up1 08-425 datë 12.11.2021 do të miratojë vendim për marrjen e lejes së tij për radioemetim, me çka në përputhje me nenin 85, paragrafi 2 të LSHMAV, radiodifuzori do të fshihet nga regjistri i radiodifuzorëve. Njoftimi Up1 nr.08-425 datë 19.11.2021, Agjencia e ka dërguar te SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP më datë 19.11.2021, në formë të shkruar me postë ekspres EMS të Postës së Maqedonisë, e cila është pranuar nga radiodifuzori më datë 23.11.2021. Gjithashtu, njoftimi i cituar i datës 19.11.2021 është dërguar me rregull në formë elektronike në adresën elektronike të transmetuesit, e regjistruar si informacion kontaktues në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është e regjistruar si adresë elektronike e radiodifuzorit në regjistrin e radiodifuzorëve të Agjencisë.

Më datë 24.11.2021, nga sektori kompetent të drejtori i Agjencisë dr Zoran Trajčevski, është dorëzuar njoftim Up1, nr.08-425 datë 24.11.2021 se deri më datë 23 nëntor 2021, në arkivin e Agjencisë nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion nga i cili mund të konstatohet se radiodifuzori i plotëson kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi 3 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga pranimi i propozimit, drejtori për të inicuar procedurë për marrjen e lejes, duhet të miratojë vendim me shumicë votash prej numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Duke marrë parasysh faktin se pronari i lejes nr.08-86 datë 5.1.2015. - SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP nuk e ka plotësuar obligimin e paraparë në nenin 62, paragrafi 6 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit, propozimin Up1 nr.08-425 datë 24.11.2021 për miratimin e vendimit për marrjen e lejes për radioemetim të SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP nga drejtori i Agjencisë dhe konkluzioni i saj nr.02-4259/3 datë 26.11.2021 u miratua vendimi me të cilin i merret leja nr.08-86 datë 5.1.2015 për radioemetim SHTR RADIO AKTUEL Manastir SHPKNJP, për arsye se pas lëshimit të lejes janë krijuar rethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes që të kryejë veprimtari radiodifuzive, respektivisht për arsye se radiodifuzori nuk i ka plotësuar kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, vendimi për heqjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit është përfundimtar, ndërkaq kundër saj pronari i lejes ka të drejtë që të parashtrojë padi te gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i saj. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart të miratohet vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve  
Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

**Udhëzim ligjor:** Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes për radioemetim të Shoqërisë tregtare radiodifuzive SHTR RADIO AKTUEL ka të drejtë padie para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.